

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-84/13**

**Prishtinë,  
14 maj 2014**

Në çështjen juridike të:

**I.A**

dhe

**I.H**

***Paraqitësi i ankesës***

kundër

**B.B1**

***Paraqitësi i Kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Willem Brouwer, Kryetare i Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/163/2012 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat: KPA32470, KPA32472, dhe KPA 32473, ) i datës 5 shtator 2012, pas seancës gjyqësore kryesore, të mbajtur më 14 maj 2014, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesat e I.A dhe I.H refuzohen si të bazuara të paraqitura kundër vendimit të KPCC /D/A /163/2012 (lënda e regjistruar në KPA, KPA32470, KPA32472, dhe KPA 32473,) i datës 5 shtator 2012.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/163 /2012 i datës 5 shtator 2012 ( lëndët e regjistruara në, në KPA, KPA32470, KPA32472, dhe KPA 32473,) i datës 5 shtator 2012,

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 03 prill 2007 B.B.1 ka depozituar tri kërkesa të regjistruara në AKP (KPA32470, KPA32472, dhe KPA 32473) në cilësinë e djalit të titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar të drejtën e ri posedimit. Ai pretendon se babai i tij i ndjerë B.B.2 është i regjistruar si bashkëpronar i 1/6 e pjesës ideale pronave të kërkuara të paluajtshme:

<b>Numri i ankesës dhe dosjes së lëndës së AKP-së</b>	<b>Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar</b>
GSK-KPA-A- 84/13 (KPA32470)	Ngastra Nr. 330/50, në vendin e quajtur "Fongishta", arë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 0.05.04 ha
GSK-KPA-A- 85/13 (KPA32472)	Ngastra Nr. 303/51 në vendin e quajtur "Fongishta", me kulturë pemishte arë e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 0.11.90 ha
GSK-KPA-A-86/13 (KPA32473)	Ngastra Nr. 303/52, në vendin e quajtur "Fongishta" arë e klasit të 3-të, në sipërfaqe prej 0.81.83 ha

2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
  - Letërnjoftimin të lëshuar me datë 17 prill 1997, nga organi kompetent i Komunës së Pejës,
  - Fleta Poseduese nr. 42 i datës 31.5.2004 të lëshuar nga Shërbimi për Kadastër të Pronës së Paluajtshme të komunës së Klinës nr. 952-1/2004-1364,
  - Fleta Poseduese nr. 42 i datës 20 shtator 2007, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi të Komunës së Klinës,

- Ekstraktin nga libri amzë i të vdekurve i lëshuar nga organi kompetent i komunës së Klinës nr. 203/1499 i datës 14.11.1994, me të cilin konstatohet se B.B2 me datë 1.11.1994 ka vdekur në Klinë.
  - Ekstrakti nga libri amzë i të lindurve të lëshuar nga organi kompetent i Pejës nr. 200-I- /1553 i datë 21.2.1997, me të cilin konstatohet se B.B.1 i biri i B.B.2 ka lindur më 22 maj 1967 në Pejë.
3. Sipas Fletë Posedimit nr. 42 të Drejtorisë për Kadastër ,Gjeodezi dhe Pronësi të Komunës së Klinës, i datës 20 shtator 2007, babai i tij i ndjere B.B.2 është regjistruar si bashkepronar ne 1/6 e pjeses ideale te parcelave te sipërtheksuara te kerkuara nga paraqitesi i kerkeses.
  4. Ekipi verifikues i Agjencisë Kosovare të Pronave sipas raportit të notifikimit dhe konfirmimit ka bërë notifikimin e ngastrave kadastrale që janë objekt i kërkesës edhe atë si më poshtë:
  5. Sipas kërkesës së KPA 32470 që i referohet ngastrës kadastrale nr. 303/50, është bërë notifikimi me 10 shtator 2010, me ç ‘rast është paraqitur pala përgjegjëse në kërkesë I.H nga fshati Kralan, komuna e Gjakovës i cili ka pretenduar të drejtën ligjore në këto prona të paluajtshme. Po kështu të drejtën pronësore për pronat që janë objekt i kërkesës të drejtën ligjore pretendon edhe I.A nga fshati Kralan, komuna e Gjakovës.
  6. Për të mbështetur pretendimet e tij I.H kanë paraqitur fletën poseduese të lëshuar nga Enti Shtetëror për Punë të Gjeodezisë të Republikës së Maqedonisë me seli në Shkup nr. 1206/1929 i datës 4.5.2004. Me këtë fletë posedim konstatohet që këto shënime janë marrë nga viti 1929 nga librat kadastrale të Banovinës së Vardarit. Po kështu sipas këtij fletë posedimi ngastra kadastrale 303/47 në vendin e quajtur “Fongishta” me kulturë livadh në sipërfaqe prej 02.38.92 ha, e që është regjistruar në emër të H.S.K nga fshati Kralan, komuna e Gjakovës.
  7. Ndërkaq, I.A ka paraqitur fletën poseduese të lëshuar nga Enti Shtetëror për Punë të Gjeodezisë të Republikës së Maqedonisë me seli në Shkup nr. 1206/1929 i datës 12.07.2004. Me këtë fletë posedim konstatohet që këto shënime janë marrë nga viti 1929 nga librat kadastrale të Banovinës së Vardarit. Sipas këtij fletë posedimi ngastra kadastrale 303/37 në vendin e quajtur “Fongishta” me kulturë livadh në sipërfaqe prej 05.86.82 ha, e që është regjistruar në emër të S.B nga fshati Kralan, komuna e Gjakovës.

8. Po kështu I.H dhe I.A kanë paraqitur secili veç e veç nga një deklaratë më datë 13.8.2008 me të cilën deklarojnë se ngastra 303/47 me kulturë livadh në sipërfaqe prej 2.38.92 ha, dhe ngastra 303/37ka qenë pronë e të ndjerit S.B e që në vitin 1932 është uzurpuar pa kurrfarë kompensimi.
9. Sipas kërkesës së KPA nr. 32472 që i referohet ngastrës kadastrale 303/51 është bërë notifikimi më 10 shtator 2010. Pala përgjegjëse në kërkesë I.H dhe I.A kanë pretenduar të drejtën ligjore për pronat e kërkuar sikundër që u theksua në paragrafët paraprake të këtij aktgjykimi.
10. Sipas kërkesës së KPA nr.32473 që i referohet ngastrës kadastrale 303/52 është bërë notifikimi më 10 shtator 2010. Palët përgjegjëse I.H dhe I.A kanë pretenduar të drejtën ligjore për këtë pronë të paluajtshme duke i paraqitur edhe dëshmitë siç u përmend në paragrafët paraprake të këtij aktgjykimi.
11. Komisioni i verifikimit sipas raportit të verifikimit të datës 26 shtator 2007 dhe 4 tetor 2007, të gjitha këto dëshmi –dokumente i ka verifikuar pozitivisht.
12. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e tij KKPK/D/A/163/12 datë 5 shtator 2012, ka vendosur që Bllagoje Bogovac është i regjistruar si bashkëpronar i pjesë ideale të 1/6 së pronave të paluajtshme të ngastrave kadastrale edhe atë: 303/50, 303/51 dhe 303/52, të cilat gjenden në vendin e quajtur “Fongishta” të zonës kadastrale “Kpuz” e të regjistruara sipas fletës poseduese 42 të Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi i datës 10 janar 2007.
13. Në arsyetimin e aktvendimit ankimor është konstatuar se paraqitësi i këtyre kërkesave B.B.1 ka paraqitur prova juridikisht të vlefshme që vërtetojnë se babai i tij i ndjerë është bashkëpronar i pjesës ideale për 1/6 të pronave të kërkuara .Ndërkaq, palët përgjegjëse në kërkesa I.A dhe I.H ,ndonëse kanë pretenduar se pronat e kërkuara u takonin stërgjysheve të tyre dhe se në vitin 1932 apo në vitin 1936, pushteti i asokohshëm ua ka konfiskuar pa kompensim, por ata kanë dështuar të paraqesin dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tyre. Paraqitësit te kërkesës vendimi i KKPK-së i është dorëzuar me 22 mars 2013. Ndërkaq, I.A dhe I.H vendimi iu është dorëzuar me 7 mars 2013 dhe se këta kanë paraqitur ankesat e veçanta më datë 5 prill 2013.

**Pretendimet ankimore:**

14. Ankuesit pretendojnë se ky vendim ankimor, është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave sikundër të drejtës procedurale ashtu edhe asaj materiale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, propozojnë që ky vendim të ndryshohet ashtu që ankuesit të lirohen nga përgjegjësia.
15. Pala ankuese I.A pretendon se ngastra kadastrale 303/37 me kulturë livadh në sipërfaqe prej 05.86.82 ha, ka qenë e paraardhësit të tij S.B dhe se në vitin 1932 e njëjta është uzurpuar nga paraardhësit e B.B.1. Ndërkaq, I.H pretendon se ngastrat kadastrale 303/47 me kulturë livadh në sipërfaqe prej 02.38.92 ,ha ka qenë e paraardhësit të tij K.S.H dhe se në vitin 1932 këtë pronë të paluajtshme e ka uzurpuar paraardhësi i paraqitësit të kërkesës B.B.1.
16. Për t'i mbështetur këto pretendimet ata kanë paraqitur cilësinë e provës fletën poseduese nr. 1206/1929 i datës 4.5.2004 të lëshuar nga Enti Shtetëror për Punë të Gjeodezisë të Republikës së Maqedonisë nga Shkupi si dhe fletën poseduese nr. 1206/1929 i datës 12.04.2004 të lëshuar nga Enti Shtetëror për Punë të Gjeodezisë të Republikës së Maqedonisë nga Shkupi. Po kështu bashkangjitur ankesës kanë paraqitur edhe deklaratat e përbashkëta të datës 13.8.2008. Me këto deklarata pretendohet se për pronat që kërkojnë të drejtën pronësore janë uzurpuar në vitin 1932 pa kurrfarë kompensimi.
17. Paraqitësi i kërkesës ka pranuar ankesat e ankuesve me dt.08 korrik 2013,me ç ‘rast ka me dt. 06 gusht 2013 hënë përgjigje në ankesë. Me këtë përgjigje në ankesë ai pretendon se babai i tij sipas dëshmive të paraqitura ai është regjistruar si pronar i ligjshëm i pronave të paluhatshme të regjistruara në emër të tije.

### **Bashkimi i ankesave:**

18. Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, parashikon se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrira, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje.
19. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën e Kontestimeve të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin

193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën e Kontestimeve, parashikojnë mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

20. Gjykata Supreme konstaton se përveq numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 3 (tri) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.
21. Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-84/13 deri 86/13, janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-84/13.

#### **Pranueshmëria e ankesave:**

22. Gjykata Supreme e Kosovës ,aktgjykimin ankimor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK, dhe pas vlerësimit të thënieve ankimore gjeti se:
- Ankesat janë të pranueshme ngase janë paraqitur mbrenda afatit ligjor sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079,ku parashikohet që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin. Kjo për arsye se, vendimi iu është dorëzuar ankuesve më 7 mars 2013 dhe se njëjtë kanë paraqitur ankesa më 5 prill 2013.

#### **Arsyetimi ligjor:**

23. Gjykata Supreme vlerëson se vendimi ankimor mbështet mbi bazën e vërtetit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike me ç ‘rast drejt janë zbatuar dispozitat e të drejtës materiale. Vendimi ankimor nuk është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimeve të cilat janë me ndikim në drejtshmërinë, ligjshmërinë dhe rregullsinë e këtij vendimi. KPCC tërësisht dhe saktësisht i ka vërtetuar faktet relevante që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm kur ka vendosur që sipas kërkesave e paraqitësit të kërkesave t’ia pranoj të drejtën e pronës së ngastrave kadastrale B.B.2 të përfshira në vendimin ankimor.

24. Objekti i shqyrtimit dhe vlerësimit ishin pretendimet ankimore të ankuesve se,pronat kontestuese ishin të paraardhësve të tyre dhe se këto prona të paluajtshme ishin uzurpuar pa kompensim në vitin 1932 nga paraardhësi i B.B.1, duke bashkangjitur fletën poseduese të Entit Shtetëror për Punë të Gjeodezisë të Republikës së Maqedonisë me seli në Shkup nr. 1206/1929 i datës 4 maj 2004 dhi dt. si dhe fletën poseduese nr. 1206/1929 i datës 12.prill 2004 si dhe deklaratat e tyre të datës 13.8.2008, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara dhe të papranueshme si dhe në kundërshtim me provat e administruara dhe faktet e vërtetuara në vendimin ankimor.
25. Pala ankuese ndonëse, pretendon se pronat e kërkuara u takonin pasardhësve të tyre dhe se në vitin 1932-1936,pushteti i asokohshëm ua ka konfiskuar pronat pa kompensim por megjithatë ata kanë dështuar të ofrojnë dëshmi-prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tyre.
26. Kjo pikërisht për arsye se, fleta poseduese i dt. 4 maj 2004 si dhe fletën poseduese nr. i datës 12.prill 2004,që i referohet shënimeve të vitit 1929 të librave kadastrale të Banovinës së Vardarit është shënuar ngastra kadastrale 303/47 dhe 303/37në vendin e quajtur “Fongishte” me kulturë livadh ,në sipërfaqe prej 02.38.92 ha, si dhe në sipërfaqe prej 05.86.82 ha, të zonës kadastrale Këpuz, Komuna e Klinës, ndërkaq me vendimin ankimor është vendosur për të drejtën e bashkëpronësisë së 1/6 të pjesës ideale të B.B.2 të ngastrave 303/50, 303/51 dhe 303/52 ,të regjistruara sipas fletës poseduese 42 të zonës kadastrale Këpuz komuna e Klinës. Prandaj, nga kjo gjendje faktike rezulton se, pretendimet ankimore lidhur me ngastrat e pretenduara nuk përputhen – nuk janë identike me ngastrat për të cilat është vendosur në vendimin ankimor. Pra, nuk ekziston identiteti objektiv për ngastrat e pronës së paluajtshme në mes të pretendimeve ankimore dhe atyre ngastrave që është vendosur në vendimin ankimor.
27. Në bazë të gjendjes së tillë të çështjes rezulton se drejt janë zbatuar edhe dispozitat e nenit 115 par. 1 të Ligjit të Pronësisë dhe Drejtave tjera Sendore. Sipas kësaj dispozite ligjoren parashikohet se fitimi, ndryshimi i përmbajtjes, bartjen, shuarjen e pronësisë në sendet e paluajtshme kërkohet punë e vlefshme juridike si dhe regjistrimi në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme. Duke qenë se pronat e paluajtshme që janë objekt i kërkesave kanë qenë të regjistruara sipas fletës poseduese nr. 42 në emër të B.B.2 ndaj edhe Gjykata Supreme konkludon se vendimi ankimor është i drejtë dhe i ligjshëm.

28. Për më tepër ,sipas dispozitës së nenit 7 par 2 të Ligjit 2002/5 për Themelimin e Regjistrit së të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, supozohet se ngastrat që janë objekt i kërkesës e që janë regjistruar në emër të B.B.2 sipas Fletës Poseduese 42 të Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi i dt.20 shtator 2007 janë të sakta, të vërteta, dhe të ligjshme derisa të mos korrigjohen në bazë të procedurave të themeluara me ligj. Prandaj, nëse eventualisht ankuesit pretendojnë se regjistri i të drejtës mbi këtë pronë të paluajtshme në Zyrë Kadastrale Klinë, nuk është i ligjshëm dhe se cenon të drejtat e tij, atëherë ka autorizime dhe përgjegjësi që sipas dispozitës së nenit 5.4 të së njëjtit Ligj të iniciojë procedurë përkatëse gjyqësore për t'i vërtetuar ato pretendime.
29. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e sipas dispozitat e nenit 13 par 3 nënpar.C Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore:**

30. Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Willem Brouwer, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**